

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Nicholson Hospitality Group" SHPK

Bazuar ne vullnetin e ortakeve dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ndryshuar me Ligjin nr. 10 475, date 27.10.2011 vendoset si me poshte:

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia e Shoqerise.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot me date 19/04/2021 themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin:

"Nicholson Hospitality Group" SHPK

Themeluesit e shoqerise **"Nicholson Hospitality Group" SHPK** jane;

- **Znj. PAOLA LO MANTO** , shtetase Italiane, e bija e Giuseppe, e datl. 26/08/1988, lindur ne Palermo, mbajttese e pasaportes se Republikes Italiane, me nr.YA7407822, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;

E cila redakton kete Akt-Themelimi, ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise nr. 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

Neni 2:

Objekti i Shoqerise.

Administrim ne fushen hotelerise te restoranteve dhe bareve, perfshire ketu dhe hapjen e tyre ne te gjithë territorin e shqiperise. Dhenie me qira te treteve. Hapjen dhe zhvillimin e qendrave tregtare, etj. Sherbime te ndryshme, ne favor te te treteve, si konsulenca, sherbime ne fushen administrative. Agjensi publicitare. Shitje, tregti, import-export, me pakice e shumice te mallrave te ndryshme, per vete dhe per te trete. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur Shoqeria mund: te kryeje cdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qera, te vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivitete keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e Shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper; te kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti qe ben pjese ne objektin e saj, qe lidhet me te dhe qe e mbeshtet ate.



Neni 3:

Kohezgjatja e shoqerise.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar.

Neni 4:

Selia e shoqerise

Rr. Rruga Brigada e VIII-te, Pallatet Agimi, shkalla 21, ap 360 Tirane 1001.

Kreu II

Kapitali i shoqerise.

Neni 5:

Vlera dhe pagesa e kapitalit te paguar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njqind mije) leke. Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte si vijon :

Lloji i kontributit eshte ne para ne vleren 100 000 (njqind) leke, i ndare ne 1(nje) kuote me vlere;

- **Znj. PAOLA LO MANTO** , eshte zoteruese e 1 (nje Kuote) me vlere 100 000 Lek (njqindmije lek), qe korrespondon ne 100 % te Kapitalit te Shoqerise.

Kreu III

Administratori i shoqerise.

Neni 6:

Emerimi dhe kohezgjatja e Administratorit.

Asambleja e pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise per nje periudhe pese vjecare (5 vjet), ne pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 date 14.04.2008, i ndryshuar. Emertimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjithshme.

- *Administratore e kesaj shoqerie eshte **Znj. PAOLA LO MANTO** , shtetase Italiane, e bija e Giuseppe, e datl. 26/08/1988, lindur ne Palermo, mbajttese e pasaportes se Republikes Italiane, me nr.YA7407822, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;*

Kreu IV

Dispozitat Perfundimtare.

Neni 7:

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Kodit te Punes si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij.

Ortaku /Ortaket e shoqerise nuk kufizohen ne rritjen e kapitalit te Shoqerise.

Mosmarreveshjet qe mund te linden gjate ushtrimit te veprimtarise private, midis ortakeve, punonjesve dhe personave te trete, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Shoqeria do te kete vullen e saj ku jane percaktuar dhe inicialet e emertimit tregtar.

Modalitet per ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do te rregullohen nga Statuti i Shoqerise dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", i ndryshuar.

Ky akt themelimi eshte perpiluar ne kater kopje me vlere te njejete me origjinalin.

Tirane, me date 19/04/2021

THEMELUESI DHE ORTAKU I VETEM

Znj. PAOLA LO MANTO

PAOLA LO MANTO
